

# AKT THEMELIMI

I

## SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"BUSA " SH.P.K.



Me anen e ketij akti themelimi , sot me date 06/05/2005 (dymije e kater )ne ortaket e shoqerise

1. MANE BULLUTI ,shtetas shqiptar, i biri imAbedinit, dtl. 1948, lindur ne Permet dhe banues ne Tirane.
2. BUJAR ÇETA, i biri i Skenderit, dtl. 1966, lindur dhe banues ne Corovode, Ne marreveshje te plote me njeri -tjetrin duke shprehur vullnetin tone te lire

### VENDOSEM

Te Themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar, e cila do te kete emertimin e saj "BUSA " SH.P.K.

#### Neni 1

##### Emertimi i Shoqerise

Shoqeria do te kete emrin e saj tregetar "BUSA " SH.P.K.

#### Neni 2

##### Forma juridike

Shoqeria "BUSA " SH.P.K. do te kete formen juridike te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar.  
Shoqeria eshte person juridik i themeluar sipas se drejtes shqiptare. Ajo zhvillon veprimtarine e vet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ,dispozitat e statutit dhe te Aktit te Themelimit.

#### Neni 3

##### Vula e Shoqerise

Shoqeria do te kete vulen e saj permbajtja e se ciles do te jete si vijon:  
"BUSA " SH.P.K.

Ne te gjitha aktet ose dokumentat qe do te nxjerre shoqeria,shenohet emri i plote i shoqerise ose i shkurtuar,vlera e kapitalit themeltar dhe administratori.

#### Neni 4

##### Selia e shoqerise

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, rruga "Komuna e Parisit", pall. 5, shkalla2, ap.7-5.  
Ndryshimi i qendres se selise se shoqerise brenda juridiksionit te rrethit te Tirane. nuk passjell ndryshime ne statut dhe kryhet me vendim te Asamblese se Ortakeve .

Ndryshimi i selise jashte rrethit Tirane do te behet me vendim te asamblese se ortakeve dhe duhet te depozitohet ne Zyren e Regjistrimit tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

**Neni 5**  
**Objekti i veprimtarise se shoqerise**

- **Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte :**

1. Aktivitet ne fushen e ndertimeve civile :

**PROJEKTIM , ZBATIM DHE NDERTIM :**

- a) Ndertime civile te te gjitha llojeve , ekonomike, industriale-turistike-bujqesore deri ne 5 kate dhe mbi 5 kate dhe rikonstrukcioni i tyre.
  - b) Ndertime rrugesh kategorite V,IV, III dhe II-I,punime te mirembajtjes dhe sinjalizimit ne rruge, ndertim mbi shtresa rrugore.
  - c) Ndertim ura dhe vepra arti deri ne 10m, ndertim ura dhe vepra arti mbi 10 m, estakada,ura metalike e te varura.
  - d) Ndertim ujesjelles, kanalizime, kanale e impiante vaditese, punime mbrojtje te sistemit hidraulik- cimentime , ndertim imiante te trajtimit te ujit.
  - e) Sillosa,kulla,kulla uji etj, b/a dhe metalike, perforcime themeli dhe e punime nentokesore,izolime mbi dhe nen tokesore nga ujrat.
  - f) Rikonstrukcione godinash civile, ekonomike, veshje fasadash etj.
  - g) Restaurimi i ndertesave monumente kulture dhe ne vepra arkeologjike.
  - h) Restaurimi i kishave, xhamive dhe cdo objekte, kulti, restaurime te brendeshme dhe te jashteme te tyre.
  - i) Punime druri dhe metal.
  - j) Instalim te impianteve ngritese dhe transportuese ( ashensore, shkalle levizese, transportues ne pergjithesi) mirembajtja e tyre.
  - k) Instalimi i impianteve higjenike, kuzhina,lavanteri, hidrosanitare-mirembajtja e tyre.
  - l) Instalim i materialeve prej druri- metalike-plastike-xhami.
  - m) Punime bojatisje- hidroizolim, termoizolim, kundra zjarrit.
2. Punime montimi ne impiantet e prodhimit dhe shperndarjes se energjise, centrale hidraulike- prova me ngarkese, centrale termike-prova me ngarkese, impiante per prodhimin e energjise nga burime alternative, instalime per nenstacionet- kabinat e transformatoreve – linjat e T.N. e te mesem,instalimi i linjave dhe kabinave elektrike te T.U. linjave per telefoni, radiotelefoni, citofoni dhe mirembajtja e tyre.
  3. Prodhime, tregeti me shumice dhe pakice , import- eksporti i materialeve te ndertimit( materiale inerte – gure, prodhime qeramike- tulla-tjegulla-fajnce,prodhime elemente betoni, betonarme te zakoneshme te paranderur, gure decorative, materiale lidhese,gelqere- allci- cemento,materiale me baze bitumi-sintetike), porti i tyre.
  4. Germime dheu me punime eventuale murature e betonarme, prishje dhe punime ne toke te germuar.
  5. Pastrim te siperfaqeve te brendeshme dhe te jashteme.

6. Punime ne siperfaqe te gjelberta, parqe, pyll-parqe, pastrim te siperfaqeve urbane.
7. Prodhim pajisjesh sinjalistike etj.
8. Rivelime topografike, punime topogjeodezike, rrjeta mbeshtetese, qendrushmeri terrenesh.
9. Import- eksport, tregeti me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem te konsumit te gjere, industriale, ushqimore, materiale ndertimi dhe inerte, linja, pajisje , pajisje elektrike, elektronike, elektroshtepiake, konfeksione , veshje te ndryshme, prodhime bujqesore e blegtorale,kanceleri etj.
10. Tregeti me pakice karburante e lubrifikante.
11. Import- eksport, tregeti me shumice dhe pakice i mobiljeve te ndryshme te gjitha llojeve, per shtepi, dyer, dritare, mobilje zyresh si dhe ndertimi dhe montimi i tyre.
12. Import- eksport tregeti me shumice dhe pakice i lendes se pare drusore, melamine dhe prodhimi i mobiljeve te ndryshme.
13. Aktivitet per organizimin e turizmit dhe agjensive te sherbimeve te ndryshme.
14. Hapje restorantesh , hotelesh, motelesh, bar – bufe.
15. Zbatime projektme dhe punime eleketrike per rryma te dobeta dhe te tensionit te larte.
16. Transport mallrash dhe udhetaresh.
17. Agjensi turistike dhe agjensi per shitje biletash per udhetare tokesore, detare dhe ajrore.

#### **Neni 6** **Kohezgjatja e shoqerise**

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet.

#### **Neni 7** **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar eshte ne vleren 100 000 ( njeqind mije leke) ,i ndare ne 100 kuota te barabarta me vlere 1000 ( nje mije) leke secila kuote Ortaket marin pjese ne kapitalin themeltar te shoqerise ne baze te kuotave te tyre respektive te cilat jane te barabarta si me poshte.

1. MANE BULLUTI ka shlyer dhe derdhur shumen prej 50 000 (pesedhjete mije ) leke baraz me 50 % te kuotave te kapitalit themeltar.
2. BUJAR ÇETA ka shlyer dhe derdhur shumen prej 50 000 ( pesedhjete mije ) leke baraz me 50 % te kuotave te kapitalit themeltar.

Kapitali fillestar i shoqerise mund te zmadhohet edhe me kontributet ne natyre. Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit fillestar te shoqerise behet me vendim te Asamblese se ortakeve. Kapitali themeltar i shoqerise nuk mund te ulet me poshte se vlera e kapitali themeltar.

Transferimi i kuotave te pjesemarjes ne kapitalin e shoqerise behet me akt-noterial duke ushtruar fillimisht te drejten e parablerjes kundrejt ortakeve.



## Neni 8

Organet Drejtuese te Shoqerise  
Organet drejtuese te shoqerise jane:  
• Asambleja e ortakeve.  
• Administratori.  
Administrator i shoqerise eshte Z. Mane Bulluti.

## Neni 9

### Zgjidhja e Mosmarreveshjeve

Cfaredo mosmarreveshje qe mund te linde midis ortakeve ( ose trashegimtareve te tyre) ose me organet e shoqerise , lidhur ne interpretimin dhe ekzekutimin e ketij akti Themelimi apo Statuti,ose qe te lidhet ne cdo menyre me mardheniet e shoqerise, duke perjashtuar vetem ato qe sipas ligjit nuk mund te perbejne objekt mosmarreveshje do te paraqitet per shqyrtim ne Gjykatën e Rrethit Tirane.

## Neni 10

Marredheniet ne Shoqeri rregullohen me dispozitat e Aktit te Themelimit , dhe statutit.

Vendimet e Asamblese se Ortakeve dhe Administratorit, te cilat ne cdo rast duhet te jene ne perputhje me ligjin. Per ceshtje qe nuk jane parashikuar ne Statut dhe Aktin e Themelimit do te zbatohet legjislacioni ne fuqi.

Kjo kontrate themelimi eshte hartuar ne kater kopje me vlere te barabarte ne gjuhen shqipe.

Per regjistrimin e shoqerise perdoret nje kopje e cila ka perparesi ligjore.

Per sa me siper ortaket rane dakort dhe nenshkruan.

## ORTAKET E SHOQERISE

MANE BULLUTI  
Mane Bulluti

Bujar Ceta  
Bujar Ceta

Rey